



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 1792 Prot

Gjirokastër më 05.02:2024

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 27.02 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 27.02 .2024.

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në 27.02 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:15.

Marrin pjesë në mbledhje 24 anëtarë. Mungojnë në mbledhje , Rova, Feruni Kristidhi, Sufati, Erion Shehaj dhe Fatjona Basha.

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31. 01.2024.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-29.02. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-29.02. 2024”.

4.P/ Vendim“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen Z.Vullnet Muho i cili është dëmtuar nga djegja e banesës së tij private si rezultat i rënies së zjarrit “

5.P/Vendim “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) për skulptorin Arben Isa Bajo”.

6.Raport i punës së Drejtorisë së Zhvillimit Bujqësor, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit dhe masat e marra për periudhën mars – qershor 2024.

7.Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2023.

8.Të ndryshme.

Dy pika të tjera të cilat këshilltarët i kanë marrë .

1.Për miratimin në parim të marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe Komunës së Bujanovcit .

P/ Vendim për autorizimin e bashkisë Gjirokastër për fillimin e procedurave për kalimin në pronësi të pronës së paluajtshme me emërtimin “Shtëpia e Oficerëve (kati i dytë dhe i tretë) që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale ”.

Znj. Isaraj pyet nëse ka dikush diçka në lidhje me rendin e ditës.

Z. Aliko: Në lidhje me pikën për shtëpinë e oficerave



Erdhi dje dhe kërkohet të miratohet. Aka një plan për çfarë do të përdoret? Sa zyra janë?

Z. Llogo: Ne sot nuk po bëjmë kalim..Po ju bëjmë kërkesë për procedurë, autorizojmë bashkinë për fillim procedurash. Mendoj të mbetet në rendin e ditës.

Z. Brahimi: Jo vetëm kjo godinë, por edhe ndertesa të tjera shtetërore të kalojnë në pronësi të bashkisë dhe të prdoren për nevojat e saj si ish-dega ushtarake, ish ndermarrja pyjore etj.

Çfarë po bëhet me konviktin të shkolla Pedagogjike, të kalojë në banesë sociale .

Gjithashtu të sensibilizohen banorët për sigurimin e banesave nga zjarri.

Z. Nebiaj: Ne nuk po e kalojmë sot në pronësi, kërkojmë autorizimin tuaj për fillimin e procedurave

Z. Drasa:Te pjesa e vendimit është bërë gabim , sepse nuk thuhet miratim në parim port ë miratojë, të rregullohet pika e parë e vendimit.

Z Aliko: Nuk kemi informacion pse do të përdorët kjo gjë nga bashkia, sepse pas 2 vjetësh mund ta përdori për gjëra të ndryshme, mund ta japë me qira për të tretët, prandaj duhet një arsyetim se përse po e marrim këtë vendim.

Z. Nebiaj: Jemi në fazën e parë të autorizimit të bashkisë , nuk e kemi ne në pronësi, ne do ti drejtohem Ministrisë së Arsimit për hapat e mëtejshëm.

Znj. Isaraj: Kjo është pronë e universitetit dhe ne ende nuk e dimë nëse e jep Ministria e Arsimit apo jo.

Hidhet në votë dhe miratohet rendi I ditës me 23 vota pro dhe një kundër, z. Aliko.

Miratohet me 24 vota pro procesverbali i mbledhjeve së datës 31. 01.2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-29.02. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-29.02. 2024”.të cilat miratohen me 24 vota pro.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës P/Vendim “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) për skulptorin Arben Isa Bajo”.

Shprehet në emër të Komisionit të Arsimit , Kulturës dhe Sportit znj. Mimoza Çabeli.

Materiali është trajtuar dhe ka kaluar në komision, duke vlerësuar kontributin e spikatur të skulptorit të talentuar, jeta e të cilit u pre në mes në moshë të re.

Hidhet në votë dhe miratohet me 24 vota pro P/Vendim “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) për skulptorin Arben Isa Bajo”.

Z. Brahimi propozon që materiali I pikës 4 të hidhet në votë, të miratohet dhe të plotësohet nga ekzekutivi me materialet që mungojnë para se të dërgohet në prefekturë për konfirmimim.

Miratohet me 24 vota pro.

. Kalohet te Raport i punës së Drejtorisë së Zhvillimit Bujqësor, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit dhe masat e marra për periudhën mars – qershor 2024

Sqaron inxhinier Diamanti sipas sektorëve të punës

Në bashkinë Gjirokastrë janë rreth 5700 ha tokë , nga e cila 3700 ha janë të mbuluara me ujë por nuk ka shumë interes për përdorimin e këtyre tokave. Drejtorja mirëmban systemin vaditës dhe ju përgjigjet kërkesave.

Z. Aliko: Sa % e tokës së fshatit Lazërat vaditet nga liqeni I Doftisë?

Z. Diamanti:Të gjitha tokat mund të ujitën ,por nuk interes për përdorimin e tyre .

Z. Brahimi: Si e furnizoni liqenin e Çinit në stinën e verës?



Z. Hilaj: Në dijeninë time qeveria ka bërë investime në Çin, në Dofti dhe në rrjetin e e furnizimit nga Doftia në Çin.

Në 3 vitet e fundit kemi patur më shumë interes nga fermerët dhe ne u jemi përgjigjur me shërbim Z. Aliko: Për liqenin e Viroit pse të mos merren masa me pnele diellore ku të punohet me pompa për thithjen e ujit dhe të pastrohet herë pas here dhe të jetë me ujë gjatë gjithë vitit.

Znj. Isaraj falënderon inxhinierin për gjithë informacionin shterues .

Hidhet në votë dhe miratohet me 23 vota pro P/ V "Për miratimin në parim të marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Gjirokastrë dhe Komunës së Bujanovcit"

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro dhe 3 ( tre) kundër, z. Aliko, Znj. Cacaj, dhe Z. Drasa P/V "Për autorizimin e bashkisë Gjirokastrë për fillimin e procedurave për kalimin në pronësi të pronës së paluajtshme me emërtimin "Shtëpia e Oficerëve (kati i dytë dhe i tretë) që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale".

Paraqitet raporti vjetor I punës së Këshillit Bashkiak Gjirokastrë për vitin 2023.

Z. Brahimi: Në raport të analizohej edhe si është sjellë ekzekutivi në raport me këshilltarët dhe sa prej kërkesave të ngritura nga ne janë marrë parasysh dhe janë zgjidhur nga ekzekutivi..Ne ngremë shqetësime dhe ato nuk zbatohen dhe nuk zgjidhen si duhet.

Mbyllet mbledhja në orë 13: 25 nga znj Isaraj.

**Sekretar i Këshillit**  
**Etleva Yzo**

**Kryetar i Këshillit**  
**Merita Isaraj**

